



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 2806/Prot.
16

Pogradec, më 29.07. 2025

VENDIM

NR. 62, DATË 28.07. 2025

MIRATIMI I PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 25.06.2025 TË
KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC

Këshilli I Bashkisë Pogradec në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces-verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes së datës 25.06.2025, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k si dhe neni 92 e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec miratuar me VKB nr 40, datë 05.03.2020.

KËSHILLI I BASHKIAK

VENDOSI:

1. Të miratojë proces verbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Pogradec , të datës 25.06.2025 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

1. Miratuar me 19 vota

2. Vota Pro 19

3. Vota Kundër 0

4. Vota Abstenim 0

5. Zbardhur më date 29.07.2025



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.06.2025

ORA : 12:00

JANË PREZENT 21 KËSHILLTARË

PROTOKOLLI I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC
DATE 25_.06.2025 , ME KËTË REND DITE.

RENDI I DITËS

1. **Projekt – Vendim:** Miratimi i Rendit të ditës.
2. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me cështjet e rendit të ditës.
3. **Projekt – Vendim :** Miratimi i Procesverbalit të datës 29.05.2025.
4. Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 29.05.2025.
5. **Projekt – Vendim :** Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike, për muajin Maj 2025.
6. **Projekt – Vendim :** “Për dhënie ndihmë financiare për z.Fiqiri Dervishllari”.
7. **Projekt – Vendim:** Për disa ndryshime në VKB nr 56 datë 19.06.2023 “Për krijimin e komisioneve të përhershme të Këshillit të Bashkisë Pogradec”
8. **Projekt – Vendim:** Për rikonfirmimin e VKB nr 131 dt 27.11.2024 “Për miratimin e planit të aktiviteteve dhe planit të konsultimeve publike të Këshillit të Bashkisë Pogradec për vitin 2025” në institucionin e Prefektit.
9. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e planit të arsimit parauniversitar të Bashkisë Pogradec.
10. **Projekt – Vendim:** Për miratimin në parim të dhënies me qira, në favor të individëve kërkues për mbarështim faunës së egër dhe gjahut, të pasurive me sipërfaqe totale 55400 m2 (pesëqind e pesëdhjetë e katër mijë)
11. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e listës së fondit kulllosor, që mund të jepen me qera, për kullotje e kositje bari, me sipërfaqe prej 1512,75 ha, në Ekonomitë Kulllosore: “Golik-Kalivac”, “Vërri- Debrovë”, “ Petrushë- Lin ”, “Guri Top- Gjëmth”, “Dunicë -Llëngë” dhe “Nicë –Valamarë”, dhe kontratës tip.



12. **Projekt – Vendim:** Për përjashtimin nga tarifa e pastrimit për subjektet : “
Armai.18 shpk ”dhe “ Larashi 2008 shpk ”

13. Raportim në Këshillin e Bashkisë për aktivitetin e Agjensisë së Mbrojtjes së
Territorit për peiudhën Janar –Qershor 2025 dhe masat e marra për sezonin
turistik..

14. **PROJEKT- VENDIM SHITES:**

-Per miratimin në parim të dhënies me qira, në favor te individeve kërkues
për ngritje fidanishte, të pasurisë me sipërfaqe totale 20400 m2 (njezet mijë
e katerqind) m2.

-Për miratimin e listës të sipërfaqes së tokës prej 2,7356 ha, e ndodhur në
njësinë administrative Cërravë që mund të jepen me qira.



Handwritten signature

1. “ Miratimi i Rendit të ditës së Mbledhjes, sipas nenit 53, pika 5, ligji 139/2015”.

Diskutime

M.Kamolli (Kryetare e Këshillit) : Mirësekeni ardhur në mbledhjen e rradhës të Këshillit Bashkiak. Materialet janë dorëzuar nga sekretariati I Këshillit në mënyrë elektronike dhe hard copy. Pa humbur kohë lexojmë projekt-vendimet që janë paraqitur për diskutim. Kemi dhe dy projekt-vendime shtesë që janë paraqitur nga administrata.

K.Topa: Në komisionet u vendos që pika 9 dhe 10 e rendit të ditës të kalojnë në konsultim public. Gjithashtu pika 12 për mungesë dokumentacioni do shtyhet për mbledhjen tjetër.

M.Kamolli: Atëherë hedhim në votim pikën e parë të rendit të ditës me ndryshime.

U votua

Pro 20

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25_. 06. 2025

2. Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.

Diskutime

M.Kamolli: Deklarimi I konfliktit të interest është një process rutinë që bëhet në fillimin e cdo mbledhjes. Nqs dikush ka konflit interesi duhet ta deklaroje .

Nuk ka asnjë këshilltar që të ketë konflikt interesi.



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.06.2025

3. “ Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 29.05.2025 të Këshillit Bashkiak Pogradec”.

Diskutime

M. Kamolli: Procesverbali I mbledhjes së datës 28.05.2025 është dërguar , nqs dikush nuk ka dicka për të diskutuar e hedhim në votim

U votua

Pro 20

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po Jo




Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më _____._____. 2025

4.Pika nr ____ : Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 29.05.2025.

Diskutime

M. Kamolli: Po Lexoj shkresën e dërguar nga institucioni I Prefektit për vendimet e mbledhjes së datës 29.05.2025

A. Male: Para se të filllojmë me diskutimin e pikave të rendit të ditës kasha dicka për të diskutuar. Ne kemi miratuar një Projekt-Vendim në muajin Janar për rritjen e pagave të punonjësve I cili u kthye nga prefektura për pjesën e afateve zgjedhore. Tani duhet të ishte future për rimiratim.

I.Karapanca (Drejore e Dr së Financave): Ne nuk e kemi parashikuar , do e studiojmë përsëri dhe do vendosim.

A.Male: Duhet të dilni me një vendim. Nqs nuk sillni rritjen e pagave është një tradhëti ndaj punonjësve.

I.Karapanca: Duhet ta diskutojmë me drejtorinë e burimeve njerëzore dhe të kthej përgjigje.



5.Pika nr . Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike, për muajin Maj 2025.

Diskutime :

M.Kamolli: Është një projekt- vendim rutinë . Po ja jap fjalën drejtoreshës së Shërbimeve Sociale, znj.Ivana LLakmani për të dhënë më shumë detaje.

I. LLakmani: Për muajin Maj janë trajtuar gjithsej 174 familje me fond 724778 lek të cilat ndahen sipas njësive administrative.

M. Kamolli: Hedhim në votim pikën 5 nqs nuk ka dikush për të diskutuar.

U votua

Pro 20

Kundër 20

Abstenim 20

Miratohet Po JO





Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.06.2025

6. “Për dhënie ndihmë financiare për z.Fiqiri Dervishllari”.

Diskutime

M. Kamolli: Është një projekt- vendim që nuk ka diskutim. Ju shprehim familjarëve të Guidos ngushëllimet tona .

A.Male: Kisha një propozim që në mbledhjen e radhës të futet një projekt-vendim për dhënien e një ndihme financiare për një punonjës të Ndërmarrjes së Mbrojtjes së Infrastrukturës dhe Punëve Publike , I cili është aksidentuar në vendin e punës dhe është në spitalin e traumës.

I.Xhakolli: Ne nuk kemi informacion për këtë rast por patjetër që do I japim interesin e duhur.

U votua

Pro	20
Kundër	20
Abstenim	20

Miratohet Po Jo



Mbledhje e Këshillit Bashkiak
më 25.06.2025

Pogradec

7. Për disa ndryshime në VKB nr 56 datë 19.06.2023 “Për krijimin e komisioneve të përhershme të Këshillit të Bashkisë Pogradec”

Diskutime

M. Kamolli: Me largimin e z. Uajd Corbaxhi si anëtar Këshilli, u emërua Z. Odhise Miihallari anëtar më I ri I Këshillit Bashkiak. Z.Uajd Corbaxhi ishte Kryetar I Komisionit të Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Rehabilitimit, I Qeverisë Elektronike dhe Teknologjisë së Informacionit si dhe anëtar në komisionin e Mireqenies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, Drejtave të Njeriut, për Marrëdhëniet me jashtë dhe Integrimin Europian të cilat propozojnë të zëvendësohen nga z.Odhise Mihallari. Nqs nuk ka ndnj diskutim ose mendim tjetër propozoj ta hedhim në votim.

U votua

Pro 20

Kundër 20

Abstenim 20

Miratohet Po JO



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.06. 2025

8: Për rikonfirmimin e VKB nr 131 dt 27.11.2024 “Për miratimin e planit të aktiviteteve dhe planit të konsultimeve publike të Këshillit të Bashkisë Pogradec për vitin 2025” në institucionin e Prefektit.

Diskutime

K. Topa: Bëhet fjalë për planin e aktiviteteve të Këshillit të miratuar me VKB NR 131 DT 27.11.2024 por që nuk është cuar për verifikim në institucionin e prefektit duke e cilësuar si Vendim me karakter individual por faktikisht është vendim me karakter normative dhe kërkon verifikimin e bazueshmërisë ligjore nga institucioni I prefektit. Ka vetëm një ndryshim që do e cilësojmë . Konsultimin public te Pba e kishim vendosur në muajin PRILL-MAJ por duke qënë se ishte periudh zgjedhore u zhvendoj në muaj Qershor Korrik dhe vendimi do zbardhet me këtë ndryshim.

M. Kamolli: Hedhim në votim pikën 8 të rendit të ditës me ndryshim

U votua

Pro 20

Kundër 20

Abstenim 20

Miratohet Po Jo

9. Për miratimin e listës së fondit kullososr, që mund të jepen me qera, për kullotje e kositje bari, me sipërfaqe prej 1512,75 ha, në Ekonomitë Kullososre: “Golik-Kalivac”, “Vërri- Debrovë”, “ Petrushë- Lin ”, “Guri Top- Gjëmth”, “Dunicë - Llëngë” dhe “Nicë –Valamarë”, dhe kontratës tip.

Diskutime

J. Bojko (Sekretare e Keshillit): Vjen Z.Diogjen Qeva

M.Kamolli: Ky projekt-vendim kaloi në konsultim public muajin e kaluar dhe pasi u kryen të gjitha konsultimet publike në Njësitë Administrative Dardhas, , Cërravë, Trebinjë, Proptisht dhe Velcan, iu dorëzuan procesverbalet e mbajtura administratës dhe u dorëzua Projekt –Vendimi .Po ja u jap fjalën këshilltarëve që ishin në konsultim public dhe specialistit të administratës për të shpjeguar si shkoi konsultimi.

C.Haxhillari: Kontrata janë 1 vjecare dhe une mendoj që kjo nuk ishte e nevojshme.

K.Gjon: Kontratat jane 1 vjecare, 3 vjecare dhe 10 vjecare. Unë isha pjesë e konsultimit në dy njësi administrative dhe mendoj që konsultimi nuk mund të quhej I suksesshëm duke qënë se prezent nuk kishte banorë që prekeshin nga ky projekt-vendim. Nuk kishte banorë që kishin kullota ishin pjesa më e madhe kryepleq.

K.Topa : Pse nuk I njoftoni ju komunitetin që është I interesuar. Ne si këshilltarë e kemi për detyrë të njoftojmë komunitetin që përfaqësojmë që të jenë pjesë e konultimeve që I prek vetë ata ose që janë të interesuar.

M.Kamolli: Kontrata tip qënka 1 vit -3 vjet, jo 10 vjet.

I.Xhakolli:Ka një ligj nga qeveria ku ne jemi të detyruar që ti japim me qera tokat që janë të pashfrytëzuara dhe që janë në pronësi të Bashkisë.Kjo pjesa e konsultimit public është një cik pengesë për ne nuk e di a është një ligj ku mbështeteni për këtë pjesë? Gjithashtu pot ë shkosh në fshat të pyesësh banorët për ti dhënë tokat me qera asnjë nuk është dakort. Ata dhe nqs nuk I punojnë përsëri nuk I japin.





K.Topa: Ka pasur raste që tokat të cilat në Ashk dalin shtet janë me Aamp të vjrtër të cilët banorët për aesyë të ndryshme nuk I regjistrojnë për këtë arsye kryejmë konsultimet publike që I pyesim banorët.

M. Biba: Duke qënë pjesë e dy konsultimeve publike kam vënë re që pjesëmarrja le për të dëshiruar. Kur pyeta pse nuk keni marrë banorë të tjerë më thanë që na thanë se duheshin vetëm kryeploqet. Banorët nuk binin dakort që të vinte dikush tjetër jo I zonës edhe ti marë tokat me qera. Në njësinë administrative Cërravë është dhënë një tokë me qera për shumë vjet dhe personi që e ka marrë nuk e vazhdon më aktivitetin. Tokat janë lënë të pashfrytëzuara.

I.Xhakolli: Janë specialistët që duhet të kontrollojnë kontratat dhe të marrin masat.

V. Pllaha: Unë bashkë me Edin ishim pjesë e konsultimit në Njësinë Administrative Trebinjë dhe atje ishte një person që ishte I interesuar .

Ë. Shyti: Unë doja ti shpjegoja pak tokat me qera sepse deri dje kanë qënë të paprekura dhe kur vjen një tjetër që është I interesuar nuk duan ti japin.

A. Male: Duket sikur janë dy palë : një palë që është dakort dhe pala tjetër që është kundër. Unë mendoj që duhet ti jepet përparësi banorëve të fshatit.

J. Shkëmbi: Ky fond nuk është miratuar sot . Ne po flasim për tjetërsim apo dhënie me qera?

K. Lufo: Sipas ligjit të kullotave dhe udhëzimeve që kemi kullotat duhet të futen cdo tre vjet në mbledhjen e Këshillit për miratim. Kemi fondin pyjor kullosor që duhet të jepet me qera , madje ka ndryshim këtë vit sepse kemi vendosur sipërfaqen e shfrytëzuar.

M.Kamolli: Ne I ajpim parimisht . Ta hedhim në votim nqs nuk ka dikush tjt kërkesë për të marë fjalën.

U votua

Pro 18 vota

Kundër 1 votë

Abstenim 2 vota

Miratohet Po Jo





Mbledhje e Këshillit Bashkiak
më 25.06.2025

Pogradec

10. PROJEKT- VENDIM SHITESË:

-Per miratimin në parim të dhënies me qira, në favor të individëve kërkues për ngritje fidanishte, të pasurisë me sipërfaqe totale 20400 m² (njetet mijë e katerqind) m²

Diskutime

J. Bojko(Sekretare e Keshillit) : Ikën Frederik Pikuli.

M. Kamolli: Fjalën po ja jap Kleas mqs ishte pjesë e konsultimit për të na shpjeguar si ishin reagimet e banorëve.

K.Topa: Ne zhvilluam të dy konsultimet publike në një ditë dhe për Projekt-Vendimin pasardhës duke qënë se ishin për të njëjtën qëllim. Sipërfaqja prej 20400 m² është në pronësi shtet dhe asnjë banor nuk shprehu pretendimet se e zotëronte me shtp të vjetër të paregjistruar.

N.Torra: Në ZK kjo sipërfaqe është kullotë por momentalisht po përdoret si kullotë dhe kërkuesi do të ngrejë fidanishte për hardhi rrushi.

M. Kamolli: E hedhim në votim nqs dikush tjt nk e do fjalën.

U votua

Pro 20

Kundër 20

Abstenim 20

Miratohet Po JO



Mbledhje e Këshillit Bashkiak

Pogradec më 25.06 2025

11. Për miratimin e listës të sipërfaqes së tokës prej 2,7356 ha, e ndodhur në njësinë administrative Cërravë që mund të jepen me qira.

K. Topa: Kërkesa për të dhënë me qera ishte për dy pasuri. Pasuria nr 8/2 dhe pasurina nr 9. Pasuria nr 8/2 ishte e gjitha e zënë me AMTP të vjetër të paregjistruar ndërsa pasuria nr 9 ishte vetëm një pjesë e zënë me Aмпt të vjetër, pjesa tjetër ishte e lirë dhe sipa regjistrave që kishte agronomi. Projekt- Vendimi këtë mbledhje erdhi I ndryshuar vetëm me sipërfaqen që ishte e lirë.

M. Kmolli: E hedhim në votim pikën 11.

U votua

Pro 20

Kundër 0

Abstenim 0

Miratohet Po **JO**

12. Raportim në Këshillin e Bashkisë për aktivitetin e Agjensisë së Mbrojtjes së Territorit për peiudhën Janar –Qershor 2025 dhe masat e marra për sezonin turistik..

Diskutime

N. Cami (Përgjegjes I sektorit të Policisë Bashkiake): Masat e marra për sezonin turistik nga Policia Bashkiake janë këto:

Një rëndësi të vecantë I kemi dhënë fshatit të Tushemishtit për heqjen e makinave të parkuara. Kemi bërë kontroll për shezllonat pa lejë. Në bashkëpunim me drejtorinë e transportit kemi hequr furgonat e parkuar . Kemi qënë dhe do të jemi në mbështetje të kativiteteve të zhvilluara nga Qndra Muultifunksionale në bashkëpunim me Bashkinë. Duke nisur nga muaji Maj , me krijimin e sistemit të gjobave të Policisë Bashkiake kemi shtuar të ardhurat nga masat e vendosura. Për pjesën e parkimeve pëe jorzidentët kemi hasur disa problem. Jemi munduar fillimisht me ndërgjegjësim.

A.Male: Kam ngritur një shqetësim të zënies së parkimeve me karrige. Duhet të ketë një monitorim për këtë pjesë.

N.Cami: Shumë e drejtë, kemi vendosur masa për këtë gjë.

A. Shkëmbi (Specialist I Mjedisit): Me krijimin e agjencisë puna jonë ka vazhduar në terren. Ne kemi punuar me paralajmërime me shkrim dhe me komunikim. Në restorante kemi hasur problemin e aromave dhe mungesës së filtrave.

I. Xhakolli: Një detyrë do keni për marrjen e masave për spërkatjen e hapesirave për ti mbrojtur nga insektet.

A. Prifti : Tek zona e restorant; Rosa e Tymosur kanë vendosur banorët që të shkojnë vetë të bëjnë dizifektim.

M. Biba: Nuk kemi marrë përgjigje për një kërkesë që une personalisht kam bërë për mungesën e ndrcimit tek varrezat e fshatit Starovë. Gjithashtu kam dhe një shqetësim për gjimnazin: Gjergj Pekmezi, I cili është I vetmi që nuk ka një





palestër. Është një fushë në ambientet e shkollës e cila mund të zihet dhe të behet palestër.

P. Ziko: Nqs ju krijohet një mundësi banorëve për strehim do shohim një mundësi që të bëhet atje ku ishte.

A. Seitllari(Jurist, Agjensia e Mbrojtjes së Territorit) ; Përsa I përket inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit ka kryzer një sërë inspektimesh në të gjithë territorin e Bashkisë Pogradec.

S.Bozdo: Pjesa e Gështenjave është në pronësi, si do të procedohet me të?

I. Xhakolli: Ekemi problem në zonat e mbrojtura sepse nuk jemi ne pronarë. Një pyetje kasha, drutë e sekuestruara ku I cojmë?

K. Lufo : Drutë e sekuestruara I cojmë në shkolla.

I. Xhakolli: Unë kasha një propozim që tja u conim familjeve në nevojë me një vendim të Këshillit Bashkiak.

D. Qeva: Në lidhje me ujrat e zeza, janë disa familje në fshatin Vërdovë që e kanë këtë problem

A.Male: Unë përgëzoj drejtuesin për punën. Për tu bërë gati për një sezon të suksesshëm duhet që të gjithë drejtuesit të bashkëpunojnë. Kam buxhetin e vitit 2025 dhe ka shumë zëra që I kam konstatuar në teren dhe nuk janë zbatuar. Në qytet ka mungesë të koshave të vegjël. Përsa I përket dizinfektimit kemi miratuar një fond të konsiderueshëm.

I. Karapanca: Për vitin 2025 na është premtuar nga ministria dizinfektimit.

I. Xhakolli: Dizinfektimi duhej bërë në një moment më të hershëm sepse duhej bërë që nga larvat.

A. Male: Dy drejtoritë Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturës dhe Punëve Publike dhe Ndërmarrja e Parqeve dhe Rekreacionit kanë buxhetin më të madh. Parku le për të dëshiruar, prej vitesh nuk është bërë asnjë ndryshim.

A.Gjoshe: Një shqetësim I madh është mirëmbajtja e varrezave te qytetit .

I.Xhakolli: Co ditë punojmë dhe nuk e dime çfarë ndodh.

M.Kamolli: Mbledhjen e deklaroj të mbyllur

Protokolli:
Sekretare e Këshillit
Jona Boyko Juf